



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2806/Prot.
16

Pogradec, më 29.07.2025

VENDIM

NR. 65, DATË 28.07.2025

PËR MIRATIMIN E

**“PLANIT TE MASAVE PER TE DALE NGA GJENDJA ME
PROBLEMEVE FINANCIARE”**

Në mbështetje të, ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 6 të nenit 57, pikës 5 të nenit 59 dhe pikës 2 të nenit 60/1, të ligjit nr. 68, datë 17.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe Udhezimit nr. 35, date 29.12.2023, “Procedura per menaxhimin e veshtiresive financiare per NJVQV-te”, dhe të Buxhetit Vjetor 2025 të Bashkisë Pogradec, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë **“Planin e masave per te dale nga gjendja me problemeve financiare”**.
2. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, pranë Bashkise Pogradec.



3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 29.07.2025



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.2025

PLANI I MASAVE PER TE DALE NGA GJENDJA ME PROBLEMEVE FINANCIARE

Në mbështetje të, ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 6 të nenit 57, pikës 5 të nenit 59 dhe pikës 2 të nenit 60/1, të ligjit nr. 68, datë 17.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe Udhezimit nr. 35, date 29.12.2023, "Procedura per menaxhimin e veshtiresive financiare per NJVQV-te", dhe të Buxhetit Vjetor 2025 të Bashkisë Pogradec, më poshtë po ju paraqesim Planin e masave për daljen nga gjëndja me Probleme Financiare.

Në buxhetin e vitit 2025 fondi per shlyerjen e detyrimeve të prapmbetura është përlllogaritur në masën prej 5,000,000 lekë.. Kjo shumë është planifikuar në fillim të vitit dhe është planifikuar nga të ardhurat e Bashkisë. Për shkak të shpenzimeve për funksionimin normal të Bashkisë dhe mbledhjes jo në masën e duhur të të ardhura Bashkia gjatë muajve Janar- Korrik 2025 nuk ka bërë asnjë shlyerje për detyrimet e prapmbetura.

Të ardhurat nuk kanë qënë në masën e planifikuar për disa shkaqe:

1. Bashkia ka përlllogaritur dhe planifikuar taksën e ndikimit në infrastrukturë, e cila do të sillte rritjen e nivelit të të ardhurave për 5 mujorin e parë por kjo taksë nuk është në nivelin e duhur për shkak të vonesave në dhëniet e lejave të ndërtimit.
2. Për shkak të rritjes së nivelit të pagave, Bashkia është ndodhur në vështirësi pasi kjo rritje është mbluar nga të ardhurat e veta.



Në bazë të analizës vjetore të dorëzuar më parë pranë jush (Raporti i Monitorimit Janar-Dhjetor 2024) rezulton që jemi në një nivel 17.63 % përsa i përket raportit ndërmjet Totalit të shpenzimeve dhe stokut, sipas tabës së mëposhtme.

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	221,599,848.06		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	60,570,605.3		
4864200	Det.Prap. Sherbime	64,466,354.6		
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	212,729		
4864400	Det.Prap. Investime	54,680,994.16		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	13,201,614		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	18,448,308		
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	2,559,255		



4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	625,898		
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	719,190		
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv	6,114,900		
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	221,599,848.06	1,256,988,401	17.63%

Duhet të theksojmë se detyrimet e prapambetura janë të krijuara në vitin 2009 më i hershmi dhe vazhdojnë deri në 2015. Përgjatë viteve në vazhdim Bashkia nuk ka krijuar borxhe të tjera përveç detyrimeve për vendime gjyqësore.

Për shkak të problemeve të sipërcituara por dhe problem të tjera Bashkia Pogradec planifikon një plan masash për likuidim si më poshtë:

Nr	Muaji	Shuma
1	Gusht 2025	1,000,000
2	Shtator 2025	1,000,000
3	Tetor 2025	1,000,000
4	Nentor 2025	1,000,000
5	Dhjetor 2025	1,000,000
	Total	5,000,000

Bashkia ka detyrime të prapambetura në shumën 221,599,848 lekë. Përqindja për të dalë nga gjëndja me probleme financiare duhet të jetë më e vogël se 15%. Përqindja jonë prej 17% do 2% ulje për të dalë nga kjo gjëndje. Shuma prej 5,000,000 lekë e planifikuar në fillim të vitit na ndihmon për të dalë nga kjo gjëndje por jo për të shlyer borxhin e madh që ka kjo Bashki.

Ulja e shumës për likuidim të detyrimeve të prapambetura është e nevojshme për shkak të funksionimit normal të punës në muajt në vazhdim. Shuma e re e planifikuar është e përballueshme nga Bashkia.



Përgjate muajve në vazhdim Bashkia do të kryejë shpenzimet e nevojshme dhe do të studiojë gjëndjen e saj. Pezullimi i veprimtarive ekonomike do të kryhet nëse do të jetë një domosdoshmeri. Kërkojme nga ana juaj miratimin e planit të mesiperm dhe presim rekomandime për funksionimin e muajve në vazhdim.

DREJTORIA E EKONOMISE

DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Irsa Karapança



**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**

